



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5684/Prot.  
1

Tiranë, më 15.10.2021

UDHËZIM

Nr. 21, datë 15.10. 2021

PËR  
KRITERET DHE PROCEDURAT PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE  
SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË, TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONE  
TË HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË  
AUTORIZUARA

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 6, të nenit 92, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të “Diplomave Profesionale/Certifikatave profesionale”, Diplomave “Bachelor”, Diplomave “Master i shkencave”, “Master i arteve” dhe “Master profesional”, “Master ekzekutiv”, “Diploma të specializimit afatgjatë” të fituar jashtë vendit, sipas përcaktimeve të ligjit për Arsimin e Lartë, Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, është Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).
2. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të gradës shkencore “Doktor”, të fituar në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, si dhe për njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vendit, sipas përcaktimeve të ligjit për Arsimin e Lartë, Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe sipas parimeve dhe standardeve

ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, është Ministria përgjegjëse për arsimin, nëpërmjet Komisioneve përkatëse. Sekretariati teknik për këtë shërbim ndodhet pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

3. Njohja dhe njësimi, në përfundim të procedurës zyrtare të njohjes, ka për qëllim njohjen e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Republikën e Shqipërisë.
4. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm, kanë këto kuptime:
  - a. “Kualifikimi” është një rezultat formal i një procesi vlerësimi dhe vlefshmërie, i përfituar prej një organi kompetent/institucioni arsimor, të akredituar, që përcakton se individi ka arritur një nivel të caktuar njohurish, aftësish dhe kompetencash në përputhje me një standard të dhënë;
  - b. “Korniza Shqiptare e Kualifikimeve”, në vijim (KSHK), sipas përcaktimeve ligjore “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve” është një sistem kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve, sipas një tërësie kriteresh, për nivele specifike të të nxënit të përftuar, që ka për qëllim integrimin dhe koordinimin e nënsistemeve kombëtare të kualifikimeve dhe përmirësimin e transparencës, aksesit, përparimit dhe cilësisë së kualifikimeve që lidhen me tregun e punës dhe shoqërinë civile.
  - c. “Korniza Evropiane e Kualifikimeve”, në vijim (KEK), sipas përcaktimeve ligjore “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, është një kornizë, që përmban 8 nivele, të miratuara nga Parlamenti Evropian, për të ndihmuar vendet dhe sektorët të krahasojnë kualifikimet, të përmirësojnë njohjen e ndërsjellë dhe të nxisin lëvizjen gjeografike, si dhe të nxënë gjatë të gjithë jetës.
  - ç. “Institucione të autorizuara” janë institucione kompetente, të cilat nuk janë institucione të arsimit të lartë, por lëshojnë diploma/certifikata profesionale, diploma të arsimit të lartë të vlefshme në vendin e origjinës, që vërtetojnë përfundimin e studimeve, konform kuadrit ligjor në fuqi të vendit përkatës.
  - d. “Rrjeti Evropian i Qendrave Kombëtare të Informacionit (ENIC-NARIC)” është një rrjet me qendra kombëtare i ngritur për të mbështetur institucionet dhe qytetarët me njohjen e kualifikimeve akademike. QSHA shërben si qendra kombëtare e rrjetit ENIC/NARIC për informimin dhe njohjen e diplomave për Republikën e Shqipërisë.
  - dh. “Refugjat” është shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij ose jashtë vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi ose dëshirë për të kërkuar mbrojtjen e atij vendi apo kthimin në atë vend, si pasojë e këtyre rrethanave, në përputhje me kriteret e nenit 1 (A) të Konventës së Gjenevës.
  - e. “Person i zhvendosur” është çdo person, i cili është detyruar të largohet nga shteti, shtetësinë e të cilit kanë, ose nga vendi ku kanë rezidencën e zakonshme/vendin e banimit të zakonshëm për të shmangur konfliktet e armatosura, dhunën, shkeljen e të drejtave të njeriut, fatkeqësitë natyrore, ose të shkaktuara nga njeriu, të cilët nuk kanë kaluar kufijtë e një shteti ndërkombëtarisht të njohur.

- f. “Persona të ngjashëm me refugjatët” është çdo person, i cili ndodhet *de facto* në një situatë të ngjashme me atë të refugjatit, personave të zhvendosur, pavarësisht statusit të tyre ligjor.
  - g. “Kualifikim i dokumentuar në mënyrë jo të përshtatshme” është kualifikimi i fituar nga mbajtësi i tij, i cili nuk mund të vërtetohet nëpërmjet dokumenteve të nevojshme.
5. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë nuk shqyrton aplikimet për rastet si më poshtë:
- a. diploma/certifikata profesionale, diploma, grada shkencore, për programe studimi të ndjekura në Republikën e Shqipërisë;
  - b. diploma/certifikata profesionale, diploma, grada shkencore për programe studimi të hapura/licencuara si programe studimi *online*, sipas përcaktimit të diplomës/suplementit/ dokumentacionit zyrtar të lëshuar nga institucioni që ka lëshuar diplomën;
  - c. dokumente për programe studimi të papërfunduara, që nuk përmbushin kushtet për të qenë diploma/certifikata profesionale, diploma, grada shkencore, të niveleve 5, 6, 7 dhe 8, sipas përcaktimeve të legjislacionit të vendit të origjinës dhe legjislacionit shqiptar. Këto dokumente shqyrtohen nga institucioni i arsimit të lartë pranë të cilit aplikohet për transferim studimesh;
  - ç. certifikata/dëshmi për kurse kualifikimi ose plotësuese, si gjuhë e huaj, kompjuter etj;
  - d. certifikata, diploma dhe grada ushtarake të fituara në institucione ushtarake të arsimit të lartë, përjashtuar diplomat për drejtime civile të studimeve. Personat që zotërojnë certifikata, diploma dhe grada ushtarake të fituara në institucione ushtarake të arsimit të lartë, në funksion të ushtrimit të së drejtës për punësim në institucione me karakter ushtarak, i drejtohen institucioneve përgjegjëse në Republikën e Shqipërisë për fushën ushtarake, për njohjen dhe njësimin e tyre, sipas legjislacionit në fuqi;
  - dh. diploma/certifikata profesionale, diploma dhe grada shkencore të fituara në institucione fetare të arsimit të lartë, përjashtuar diplomat me drejtim civil studimi.

Për rastet e përmendura në këtë pikë të udhëzimit, aplikanti njoftohet zyrtarisht për mos shqyrtimin e aplikimit.

6. Kriteret që duhet të përmbushë diploma/certifikata profesionale dhe grada shkencore për t’u njohur dhe njësuar janë:
- a. të jetë lëshuar nga institucione të licencuara, të njohura dhe/ ose të akredituara të arsimit të lartë në vendin e origjinës;
  - b. programi i studimit në përfundim të të cilit lëshohet diploma/certifikata profesionale apo diploma të jetë i njohur/akredituar në datën e lëshimit të saj;
  - c. certifikata apo diploma të jetë e vlefshme në vendin e origjinës;
  - ç. certifikata apo diploma të jetë autentike.
7. Informacioni paraprak mbi institucionet e arsimit të lartë që ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me standardet përkatëse të vendit të origjinës mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit të Rrjetit Evropian të Qendrave Kombëtare të Informacionit (ENIC-NARIC). Në

lidhje me dhënien e informacionit për të interesuarit për sistemin dhe institucionet e arsimit të lartë si dhe kualifikimet e lëshuara prej tyre në Republikën e Shqipërisë institucion përgjegjës është QSHA.

## KREU II

### PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI

1. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare, Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, si dhe titujve akademikë kryhet *online* nëpërmjet portalit e-Albania.
2. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar duhet të depozitohet detyrimisht në formatin elektronik gjatë aplikimit *online*, si dhe të dërgohet brenda 5 (pesë) ditëve nga data e aplikimit *online* edhe në rrugë postare sipas përcaktimeve të mëposhtme.
3. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve akademike që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare ose Evropiane të Kualifikimeve, përveç gradës shkencore “Doktor”, kryhet *online* sipas procedurës së mëposhtme:
  - a. formulari i aplikimit plotësohet *online* në portalin e-Albania, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij;
  - b. aplikanti ngarkon në format elektronik (PDF) dokumentacionin e mëposhtëm:
    - i. diplomën/certifikatën profesionale, diplomën ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të pajisur me vulë apostile ose legalizim nga vendi i lëshimit, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.
    - ii. suplementin e diplomës dhe/ose listën e notave, të pajisur me vulë apostile ose legalizim nga vendi i lëshimit, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.
    - iii. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj);
    - iv. mandat-pagesën ose konfirmimin e pagesës *online*, sipas shtojcës nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.
- 3.1 Në rrugë postare pas kryerjes së aplikimit *online*, dërgohet në QSHA, dokumentacioni i specifikuar në pikën 3/a, 3/b/i dhe 3/b/ii, të kreut II, të këtij udhëzimi.
4. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore “Doktor” kryhet *online* sipas procedurës së mëposhtme:
  - a. formulari i aplikimit plotësohet *online* në portalin e-Albania, sipas shtojcës nr. 1;
  - b. aplikanti ngarkon në format elektronik (PDF) dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. diplomën dhe suplementin e saj (nëse ka të tillë), lëshuar nga institucioni përkatës i arsimit të lartë, që dëshmon fitimin e gradës shkencore “Doktor” ose dokumentin original të barasvlershëm me diplomën në rastet kur ky përbën dokumentin zyrtar përkatës në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën, të pajisur me vulë apostile ose legalizim nga vendi i lëshimit, të njëzuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.
  - ii. diplomën e studimeve pararendëse të arsimit të lartë dhe/ose vërtetimin e njësimit të diplomës i lëshuar nga institucioni përgjegjës në Republikën e Shqipërisë;
  - iii. disertacionin e doktoratës. Në rast se disertacioni është në gjuhë të huaj, aplikanti paraqet një përmbledhje në gjuhën shqipe;
  - iv. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj);
  - v. mandat-pagesën ose konfirmimin e pagesës *online*, sipas shtojcës nr. 2.
- c. Aplikanti duhet të depozitojë një kopje të disertacionit përkatës në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë (BKSH) dhe të paraqesë vërtetimin përkatës.

4.1 Në rrugë postare pas kryerjes së aplikimit *online*, dërgohet në QSHA, dokumentacioni i specifikuar në pikën 4/a, 4/b/i dhe 4/b/ii, të kreut II, të këtij udhëzimi.

5. Institucioni përgjegjës për njohjen në Republikën e Shqipërisë të titujve akademikë të fituar jashtë vendit, bazohet në kriteret dhe standardet shtetërore të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, në Republikën e Shqipërisë, për fitimin e titujve akademikë.

5.1 Aplikimi për njohjen e titujve akademikë kryhet *online* sipas procedurës së mëposhtme:

- a. formulari i aplikimit plotësohet *online* në portalin e-Albania, sipas shtojcës nr. 1;
- b. aplikanti ngarkon në format elektronik (PDF) dokumentacionin e mëposhtëm:
  - i. dokumentin e fitimit të titullit akademik, të pajisur me vulë apostile ose legalizim nga vendi i lëshimit, të njëzuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;
  - ii. diplomën e studimeve pararendëse universitare, nëse kjo diplomë është fituar në Republikën e Shqipërisë ose kopje e doktoratës e noterizuar shoqëruar me vërtetimin e njohjes së gradës shkencore “Doktor” në Republikën e Shqipërisë, nëse studimet pararendëse janë ndjekur jashtë vendit;
  - iii. vërtetimin e regjistrimit të titullit akademik në bazën e të dhënave përkatëse në zbatim të kuadrit ligjor të vendit ku është fituar titulli akademik (nëse ky regjistrim është parashikuar nga legjislacioni përkatës i huaj);
  - iv. fotokopjen e kartës së identitetit apo pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj);
  - v. mandat-pagesën ose konfirmimin e pagesës *online*, sipas shtojcës nr. 2;
  - vi. deklaratën/skedën e nënshkruar në të cilin të jepet informacion për eksperiencën akademike në mësimdhënie; aktivitetin shkencor – lista e artikujve/botimeve shkencore, pjesëmarrje në simpoziume, konferenca, kongrese shkencore të shoqëruar me titujt e materialeve të paraqitura; si dhe botime të punimeve shkencore në organe shkencore ndërkombëtare. Informacioni i parashikuar në këtë skedë duhet të shoqërohet me dokumentacionin provues përkatës.

5.2 Në rrugë postare pas kryerjes së aplikimit *online*, dërgohet në QSHA, dokumentacioni i specifikuar në pikën 5/a dhe 5/b/i, të kreut II, të këtij udhëzimi.

### KREU III PROCEDURAT E NJOHJES DHE NJËSIMIT

1. Procedura e njohjes dhe njësimit, pas aplikimit *online*, e kualifikimeve akademike që i përkasin nivelit 5 deri në 8, përveç gradave shkencore “Doktor”, të Komizës Shqiptare ose Evropiane të Kualifikimeve vijon me shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit nga ana e Komisionit të Njohjes së Diplomave në QSHA. Kjo procedurë, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzimi, përfundon brenda 45 ditëve.
- 1.1 Sektori i Njohjes së Diplomave të Arsimit të Lartë (SENJOD) në QSHA shërben si sekretariat teknik i Komisionit të Njohjes së Diplomave.
- 1.2 Aplikimi nuk konsiderohet i plotë nëse mungon një nga dokumentet e cituara në këtë udhëzim.  
Informimi për plotësim dokumentacioni bëhet me postë elektronike. Procedura e njohjes dhe njësimit fillon menjëherë pasi QSHA-së i është shfaqur aplikimi në sistemin *online* në rastet kur dokumentacioni i ngarkuar në formë elektronike është i plotë sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.  
Brenda 3 (tri) ditëve nga fillimi i procedurës së njohjes dhe njësimit SENJOD kontakton me anë të postës elektronike me institucionin përgjegjës që ka lëshuar diplomën ose certifikatën përkatëse.
- 1.3 Në çdo rast, procedura e njohjes dhe njësimit nuk mund të përfundojë nëse aplikanti nuk paraqet në formatin shkresor dokumentacionin e parashikuar në këtë udhëzim, në QSHA.
- 1.4 Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacion, SENJOD i kërkon aplikantit fillimisht plotësimin e dokumentacionit me anë të postës elektronike, brenda 15 ditëve nga momenti i depozitimit të aplikimit. Në rast të mos depozitimit të plotësimeve brenda 30 ditëve, aplikantit i kërkohen plotësime për herë të dytë me anë të postës elektronike, të cilat duhet të depozitohen brenda 30 ditëve në QSHA, në të kundërt, shqyrtimi i aplikimit përkatës ndërpritet dhe dokumentacioni arkivohet në QSHA.
- 1.5 SENJOD llogarit afatet e përcaktuara në këtë udhëzim për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve, duke iu referuar datës së plotësimit të praktikës me të gjithë dokumentacionin e plotë.
2. QSHA në zbatim të procedurës së verifikimit:
  - a. kërkon informacion nëse programi i studimit i përfunduar nga aplikanti në një institucion të huaj të arsimit të lartë apo institucion tjetër i autorizuar është i hapur/licencuar si program studimi *online*;
  - b. kërkon çdo informacion shtesë që e konsideron të nevojshëm për vlerësimin objektiv për njohjen dhe njësimin e diplomës/certifikatës;
  - c. i kërkon përmes postës elektronike IAL-së përkatëse konfirmimin e autenticitetit, të paktën dy herë dhe në rast mos përgjigjeje, konfirmimi kërkohet me shkresë zyrtare (dërguar me postë zyrtare). Në rast se pas 1 viti nga momenti i kërkesës së konfirmimit me shkresë zyrtare, ende nuk ka një përgjigje nga IAL-ja, shqyrtimi i

aplikimit përkatës ndërpritet dhe dokumentacioni arkivohet në QSHA. Aplikanti njoftohet për vendimin e komisionit mbi arkivimin e dokumentacionit.

Gjithashtu, konfirmimi kërkohet edhe nga institucionet e tjera përgjegjëse sipas rastit;

- ç. QSHA i referohet listës zyrtare të institucioneve të njohura/licencuara/ akredituara në vendin e origjinës të publikuar në faqet përkatëse zyrtare të rrjetit ENIC-NARIC dhe sipas rastit kërkon informacion pranë qendrave të rrjetit evropian të informimit dhe njohjes së diplomave (ENIC–NARIC) dhe institucioneve përgjegjëse të shteteve të tjera mbi statusin e institucioneve të arsimit të lartë, vlefshmërinë e diplomave apo certifikatave, nivelin e tyre sipas kornizës kombëtare apo evropiane të kualifikimeve, si dhe informacion tjetër shtesë në funksion të njësimit të diplomës. QSHA shërben si qendra kombëtare e rrjetit ENIC/NARIC për informimin dhe njohjen e diplomave për Republikën e Shqipërisë;
  - d. materialet shpresore ose të printuara për të gjitha verifikimet e kryera, depozitohen në dosjen e aplikantit. Për verifikimet e kryera *online*, dokumentacioni i printuar firmoset nga nëpunësi që kryen verifikimet dhe depozitohet në dosjen e aplikantit.
3. Komisioni i Njohjes së Diplomave përbëhet nga tre anëtarë dhe drejtohet nga kryetari, i cili caktohet nga titullari i QSHA-së. Komisioni i Njohjes së Diplomave shqyrton, njeh dhe njëson kualifikimet akademike që i përkasin nivelit 5 deri në 8, përveç gradave shkencore “Doktor”, në bazë të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat përfshihet vendi ynë duke respektuar dhe parashikimet e kuadrit ligjor shqiptar në fuqi.
  4. Në zbatim të parimit të barazisë dhe mos diskriminimit, bazuar në përcaktimet e shkronjës “b”, të nenit 75 të pikës 2, të nenit 124, të ligjit nr. 80/2015:
    - a. Diplomat e fituara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë, përpara aplikimit të sistemit të Bolonjës në Shqipëri, të cilat e kanë datën e lëshimit të diplomës deri në vitin 2010, me kohëzgjatje normale minimale 4 (katër) vite (tetë semestra), me kohë të plotë, të njësohen si ekuivalentët e tyre që ofroheshin në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, në të njëjtën periudhë kohore.
    - b. Diplomat e lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë, për programet e studimit të cilat përmbajnë të paktën 300 ECTS, me kohëzgjatje normale minimale 5 (pesë) vite akademike, të njësohen si ekuivalentët e tyre që ofrohen në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.
  5. Komisioni i Njohjes së Diplomave merr vendimin për njohje dhe njësim të certifikatës/diplomës ose mund të vendosë ta kthejë për plotësime të tjera të nevojshme të dokumentacionit te sekretaria teknike (SENJOD), sipas këtij udhëzimi. Sekretaria teknike (SENJOD) zbardh raportin dhe vendimin e Komisionit të Njohjes së Diplomave, i cili lëshon vërtetimin e njohjes dhe njësimit për çdo aplikant, sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij. Në rastet kur ky Komision nuk merr vendim për njohjen

dhe njësimit të diplomës ose certifikatës, i kthen përgjigje të arsyetuar aplikantit për arsyet dhe mangësitë e aplikimit.

6. Për njohjen e gradave shkencore “Doktor” ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, Komisioni i Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore (KNjG), i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për arsimin.
  - 6.1 KNjG përbëhet nga kryetari dhe nga një anëtar, për secilën prej fushave të studimit dhe kërkimit shkencor, pedagog i kategorisë “Profesor”.
  - 6.2 Sektori i Njohjes së Diplomave në QSHA shërben si sekretariat teknik i KNjG.
  - 6.3 KNjG mblidhet periodikisht në varësi të numrit të aplikimeve. Procedura për shqyrtimin e dosjeve nga KNjG fillon në momentin që SENJOD në QSHA vlerëson se janë të plota për shqyrtim dosjet për njohjen e gradës shkencore “Doktor”, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.
  - 6.4 Në përfundim të procedurave të shqyrtimit, kryetari dhe anëtarët e komisionit, nënshkruajnë procesverbalin dhe vendimin përkatës. Kryetari lëshon vërtetimin për njohjen e gradës shkencore, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.
  - 6.5 Procedura e njohjes dhe njësimit të gradës shkencore të fituar jashtë vendit, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzimi, përfundon brenda 45 ditëve.
  - 6.6 Përcaktimet e pikave 1.2 dhe 1.3 të kreut III të këtij udhëzimit, lidhur me afatet procedurale, aplikohen edhe për aplikimet për njohjen dhe njësimin e gradave shkencore të fituara jashtë vendit.
7. Për njohjen e titujve akademikë ngrihen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin komisione *ad hoc*, për secilin aplikim për njohje titulli akademik të fituar jashtë vendit, me pedagogë ekspertë të fushës përkatëse të kategorisë “Profesor”. Komisionet *ad-hoc* për njohjen e titujve akademikë kryesohen nga ministri përgjegjës për arsimin dhe përbëhen nga kryetari dhe katër anëtarë.
  - 7.1 Sektori i Njohjes së Diplomave në QSHA shërben si sekretariat teknik i komisioneve *ad hoc*.
  - 7.2 Kërkesa për ngritjen e komisionit *ad hoc* kryhet nga Sektori i Njohjes së Diplomave në QSHA, menjëherë pas depozitimit të aplikimit për njohjen e titullit akademik të fituar jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi.
  - 7.3 Në përfundim të procedurave të shqyrtimit dhe vlerësimit, kryetari dhe anëtarët e komisionit *ad hoc* nënshkruajnë procesverbalin dhe vendimin përkatës. Nëse është vendosur njohja e titullit akademik, atëherë kryetari lëshon vërtetimin përkatës sipas shtojcës nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.
  - 7.4 Procedura e njohjes së titullit akademik të fituar jashtë vendit, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzimi, përfundon brenda 45 ditëve.
  - 7.5 Përcaktimet e pikave 1.2 dhe 1.3 të kreut III të këtij udhëzimit, lidhur me afatet procedurale, aplikohen edhe për aplikimet për njohjen dhe njësimin e gradave shkencore të fituara jashtë vendit.



8. Komisioni i Njohjes së Diplomave në QSHA, KNjG dhe komisionet *ad hoc*, për certifikata, diploma ose grada shkencore, si dhe tituj akademikë, interpretojnë dhe marrin vendim të argumentuar mbi njohjen ose jo, të mbështetur në legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara si edhe në praktikat më të mira të vendeve perëndimore.
9. Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit, për diplomat që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ose Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, (përveç gradave shkencore “Doktor”) lëshohet i firmosur nga titullari i QSHA-së dhe kryetari i komisionit në dy kopje origjinale (njëra kopje i bashkëngjitet vendimit përkatës të Komisionit të Njohjes së Diplomave dhe ruhet në dosjen e aplikimit përkatës).
10. Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit të certifikatave/diplomave të nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ose Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, me përjashtim të gradave shkencore, përmban minimalisht elementet e mëposhtme:
  - a. emrin, atësinë dhe mbiemrin e aplikantit;
  - b. institucionin e huaj të arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën;
  - c. shtetin përkatës;
  - ç. numrin e krediteve ECTS (nëse mund të përcaktohet);
  - d. emërtimin e plotë të programit të studimit;
  - dh. formën e studimit;
  - e. kohëzgjatjen e programit të studimit;
  - ë. datën e lëshimit të diplomës;
  - f. njohjen dhe njësimin e diplomës/certifikatës në Republikën e Shqipërisë.
11. Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit të gradës shkencore “Doktor”, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij, përmban minimalisht elementet e mëposhtme:
  - a. emrin, atësinë dhe mbiemrin e aplikantit;
  - b. institucionin e huaj të arsimit të lartë që ka lëshuar gradën shkencore “Doktor”;
  - c. shtetin përkatës;
  - ç. datën e fitimit të gradës shkencore “Doktor”;
  - d. fushën e studimit;
  - dh. temën e disertacionit;
  - e. numrin dhe datën e vendimit të KNJG;
  - ë. numrin rendor të regjistrimit të gradës shkencore “Doktor” në regjistrin shtetëror të gradës shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit;
  - f. njohjen dhe njësimin e gradës shkencore “Doktor” në Republikën e Shqipërisë.
12. Vërtetimi i njohjes së titujve akademikë, përmban minimalisht elementet e mëposhtme:
  - a. emrin, atësinë dhe mbiemrin e aplikantit;
  - b. institucionin e huaj të arsimit të lartë që ka lëshuar titullin akademik;
  - c. emërtimin e titullit të fituar;
  - ç. shtetin përkatës;

- d. datën e fitimit të titullit akademik;
- dh. fushën e studimit;
- e. numrin dhe datën e vendimit të komisionit *ad hoc*;
- ë. numrin rendor të regjistrimit të titullit akademik në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit.

13. QSHA është institucioni përgjegjës për mbajtjen dhe plotësimin e regjistrit shtetëror të njohjes dhe njësimit të diplomave dhe regjistrit shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë. Regjistrat mbahen në formatin *hard copy* dhe në atë elektronik. QSHA publikon listën emërore të personave të cilëve u janë njohur dhe njësuar diplomat në faqen e saj zyrtare të internetit.

#### KREU IV

### NJOHJA E DIPLOMAVE TË PERSONAVE QË KANË STATUSIN E REFUGJATIT, PERSONAVE TË ZHVENDOSUR DHE PERSONAVE TË NGJASHËM ME REFUGJATËT

1. Për personat që kanë statusin e refugjatit, personit të zhvendosur dhe/ose personit të ngjashëm me refugjatin nuk zbatohen procedurat e parashikuara në Kreun II të këtij udhëzimi.
2. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve akademike që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare ose Evropiane të Kualifikimeve, përveç gradës shkencore “Doktor”, kryhet sipas procedurës së mëposhtme:
  - a. formulari i aplikimit plotësohet në QSHA, sipas shtojcës nr. 1;
  - b. aplikanti dorëzon në QSHA dokumentacionin e mëposhtëm:
    - i. diplomën/certifikatën profesionale, diplomën ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.
    - ii. suplementin e diplomës dhe/ose listën e notave, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.
    - iii. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës, ose dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet identiteti i tij;
    - iv. dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet që personi ka fituar statusin e refugjatit, person i zhvendosur dhe person i ngjashëm me refugjatët;
3. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore “Doktor”, kryhet sipas procedurës së mëposhtme:

- a. formulari i aplikimit plotësohet në QSHA, sipas shtojcës nr. 1;
  - b. aplikanti dorëzon në QSHA dokumentacionin e mëposhtëm:
    - i. diplomën/certifikatën profesionale, diplomën ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.
    - ii. suplementin e diplomës dhe/ose listën e notave, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.
    - iii. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës, ose dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet identiteti i tij;
    - iv. dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet që personi ka fituar statusin e refugjatit, person i zhvendosur dhe person i ngjashëm me refugjatët.
4. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e titujve akademik, kryhet sipas procedurës së mëposhtme:
- a. formulari i aplikimit plotësohet në QSHA, sipas shtojcës nr. 1;
  - b. aplikanti dorëzon në QSHA dokumentacionin e mëposhtëm:
    - i. diplomën/certifikatën profesionale, diplomën ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.
    - ii. suplementin e diplomës dhe/ose listën e notave, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.
    - iii. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës, ose dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet identiteti i tij;
    - iv. dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet që personi ka fituar statusin e refugjatit, person i zhvendosur dhe person i ngjashëm me refugjatët.
5. Refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët, të cilët paraqesin dokumentacion të pjesshëm, ose nuk mund të paraqesin dokumente për të vërtetuar kualifikimet e tyre dhe/ose periudhat e studimit, kanë të drejtën e njohjes dhe njësimit pa pagesë dhe brenda një afati të arsyeshëm të kualifikimit të tyre dhe/ose periudhave të studimit me qëllim për të vazhduar studimet e mëtejshme, ose për tu punësuar.
6. Për njohjen dhe /ose njësimin e diplomave/certifikatave profesionale, diplomave që u përkasin niveleve 5-8, gradave shkencore, titujve akademikë dhe kualifikimet e tjera të fituara jashtë Republikës së Shqipërisë dhe/ose periudhave të studimit nga mbajtësit/titullarët e statusit të refugjatit, personave të zhvendosur dhe personave të ngjashëm me refugjatët, organet kompetente, përcaktojnë procedurat e përshtatshme të vlerësimit, vlefshmërisë dhe kritereve të tjera, që lejojnë njohjen e këtyre kualifikimeve dhe/ose periudhave të studimit, edhe në mungesë të verifikimit të vlefshmërisë së tyre, apo

mungesës, apo paraqitjes së dokumentacionit të pjesshëm ligjor, në ato raste kur personat e interesuar provojnë pamundësinë për të verifikuar vlefshmërinë e këtyre diplomave/certifikatave, ose nuk mund të paraqesin dokumente që ta bëjnë këtë gjë.

7. Për njohjen e kualifikimeve dhe periudhave të studimit të përcaktuara në këtë kre të këtij kreu, organet kompetente i referohen dispozitave përkatëse të këtij udhëzimi, Konventës së Lisbonës, të ratifikuar me ligjin nr. 8834, datë 22.11.2001 *“Për ratifikimin e “Konventës për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Europë” (Lisbonë, 1997)”*, si dhe dokumenteve të tjera ndërkombëtarë të njohura nga rrjeti ENIC-NARIC.
8. Kualifikimet e paraqitura sipas përcaktimeve të këtij kreu, duhet të vlerësohen nëpërmjet mbledhjes së informacionit nga burime të besueshme publike, rrjeti ENIC-NARIC, nga personi që aplikon për njohjen e kualifikimit dhe/ose periudhave të studimit dhe sipas rastit duhet të plotësohet me intervista me aplikantin, provimet dhe çdo metodë tjetër të përshtatshme vlerësimi.  
Organet kompetente për njohjen dhe njësimin e diplomave dhe/ose periudhave të studimit, duhet të përdorin çdo mjet të disponueshëm dhe çdo informacion të besueshëm për të verifikuar programet e studimit, institucionet ku janë fituar kualifikimet, apo janë kryer periudhat e studimit dhe gjithashtu të përdorin për aq sa është e mundur çdo informacion apo praktikë të vlerësimeve të mëparshme për kualifikime të ngjashme përsa i përket vlefshmërisë, cilësisë, nivelit dhe rezultateve të të nxënit.
9. Organet kompetente në rastet kur refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët, për arsye të përligjura nuk mund të provojnë dhe dokumentojnë kualifikimet e tyre dhe /ose periudhat e studimit që ata pretendojnë, hartojnë një raport, i cili duhet të përmbajë një informacion të detajuar për kualifikimin e fituar, ose periudhave e studimit të përfunduara, me të gjithë dokumentacionin provues dhe dëshmitë mbështetëse të përshkruara në pikën 6 të këtij kreu.  
Raporti i hartuar nuk përbën në vetvete një dokument njohjeje dhe njësimi.
10. Në të gjitha rastet raporti duhet të përmbajë:
  - a. të dhënat personale të aplikantit (emër, mbiemër, atësi (nëse shënohet));
  - b. emrin, në gjuhën origjinale të kualifikimit të fituar;
  - c. emrin, në gjuhën origjinale të institucionit ku është fituar kualifikimi, ose janë kryer periudhat e studimit;
  - d. emrin, në gjuhën origjinale të programit të studimit;
  - e. statusin e institucionit dhe programit të studimit (licencuar, akredituar/njohur, vlefshmërinë);
  - f. nivelin e kualifikimit të fituar;
  - g. kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit;
  - h. të drejtat e fituara nga kualifikimi;
  - i. vitin në të cilin është fituar kualifikimi, ose është kryer periudha e studimit;
  - j. dokumentacioni përkatës ku është mbështetur raporti.

10.1 Raporti hartohet dhe lëshohet në gjuhën shqipe dhe në atë angleze.

11. Refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët, kanë të drejtën e ankimit sipas kreut VI të këtij udhëzimi.

## KREU V

### TARIFAT

1. Tarifat për njohjen dhe njësimin e certifikatave/diplomave dhe gradave shkencore, që i përkasin nivelit 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, si dhe titujve akademikë, për çdo diplomë/titull akademik që kërkohet të njihet, përveç aplikimeve të paraqitura nga refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët i referohen përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Pagesa për njohjen dhe njësimin e certifikatave/diplomave dhe gradave shkencore, që i përkasin nivelit 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, si dhe titujve akademikë kryhet në llogarinë bankare të QSHA, të përcaktuar në faqen zyrtare të QSHA dhe e-Albania, në seksionin përkatës të njohjes së diplomave.

## KREU VI

### ANKIMIMI

1. Aplikanti për njohjen dhe njësimin e certifikatave dhe diplomave që i përkasin nivelit 5 deri në 8, përveç gradave shkencore “Doktor”, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim kundër vendimit të Komisionit të Njohjes së Diplomave në QSHA, sipas afateve të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.
2. Aplikanti për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore “Doktor” dhe titujve akademikë ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim kundër vendimit të KNJG ose komisionit *ad hoc* pranë MAS, sipas afateve të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.
3. Ankesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin mbi të cilin mbështeten pretendimet e ankuesit.

## KREU VII

### DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

1. Personat të cilët kanë aplikuar dhe/ose kanë paraqitur dokumentacionin për njohjen dhe njësimin e diplomave përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të trajtohen në bazë të dispozitave të udhëzimit nr.17, datë 03.08.2016, "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit", i ndryshuar.
2. Udhëzimi nr.17, datë 03.08.2016, "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit", i ndryshuar, shfuqizohet.
3. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Arsimit, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe komisionet përkatëse.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Evis KUSHI





Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:  
E-mail: senjod@qsha.gov.al  
Web: www.qsha.gov.al

HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN

Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN

1. Emri

2. Mbiemri

3. Emri i Babait

4. NID  
*Nr. i identifikimit personal*

5. Gjinia  Mashkull  Femër

6. Datëlindja     
*Data Muaji Viti*

7. Vendlindja

8. Shtetësia

9. Adresa

10. Qyteti

11. Bashkia

12. Kodi Postar

13. E-mail

14. Nr. Tel. Celular

15. Nr. Tel. Fiks

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

16. Njohje Diplome  Program studimi me karakter profesional pas arsimit të mesëm  Bachelor  Master  Cikël i tretë i studimeve (*Master Ekzekutiv, Specializim afatgjatë, Doktoratë*)  
Titull akademik  Titull akademik

17. Programi i studimit/  
titulli akademik që donihet

18. Emri i Institucionit të Arsimit të Lartë (IAL)

19. Pranuar më

20. Diplomuar më

21. Kohëzgjatja zyrtare (vite)

22. Semestra

23. Niveli i studimeve i kërkuar për pranimin në këtë program studimi  
 Shkolla e mesme  Bachelor  Cikël i dytë i studimeve (*Master i shkencave/profesional*)  Cikël i tretë i studimeve (*Master Ekzekutiv, Specializim afatgjatë, Doktoratë*)

24. Niveli i studimit që mund të ndiqet me diplomën që keni paraqitur kërkesën për njohje  
 Cikël i dytë i studimeve (*Master i shkencave/profesional*)  Cikël i tretë i studimeve (*Doktoratë*)  Post Doktoratë  Nuk jep akses në studime të mëtejshme

25. Kontaktet zyrtare të IAL-së, ku jeni diplomuar

Adresa

Qyteti

Kodi Postar

Adresa web

Shteti

E-mail

Nr. Tel. Fiks

**KLAUZOLA DEKLARATIVE**

Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisën procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se nuk kam aplikuar më parë për njohje dhe njësime të kësaj diplome pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin apo Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe në respektim të ligjit Nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" të ndryshuar, autorizoj me vullnetin tim të lirë institucionin, të përpunojë dhe të përdorë të dhënat e mia personale, për qëllime statistikore dhe të shqyrtimit të aplikimit.

*Njoftojmë se autorizimi i mëposhtëm është vullnetar.*

Autorizoj institucionin të përpunojë të dhënat e mia personale (emër, mbiemër, numër telefoni ose email) të mbledhura më sipër, me qëllim zhvillimin e sondazheve të automatizuara për marrjen e opinionit tim, në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit. Autorizoj dhe lejoj institucionin që të kërkojë të dhënat e mia arsimore në institucionin e arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën për të cilën po aplikoj për njohje dhe njësime.

Nënshkrimi i aplikantit

Data		Muaji			Viti				



Shtojca nr.2

**QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE  
TIRANË**

**FATURE PËR ARKËTIM**

Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2021

Me anë të kësaj fature kërkojmë që Banka e Nivelit të Dytë të pranojë nga klientë (persona / persona fizik/persona juridik) arkëtime, për llogari të institucionit tonë, me emërtime, kode, numër identifikimi dhe shuma si më poshtë:

Emri i Institucionit përfitues

Kodi i Institucionit përfitues

Kodi i Degës së Thesarit ku vepron

Emri Atësia Mbiemri i paguesit

Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)

1011055

3535

ID e Detyrimit	Përshkrimi i të ardhurave		Shuma që Arkëtohet (Lekë)
	Emërtimi	Kodi i Llogarisë Ekonomike	
	Bachelor, Master, Specializime Afatgjata, titujt akademikë dhe doktoratë, të lëshuara nga IAL-të e huaja, për njohje dhe njësime	7110103	2000
X	<b>TOTALI</b>	X	2000

( \_\_\_\_\_ ) lekë

Përfaqësuesi i Institucionit  
Rezana VRAPI

KLIENTI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE  
KOMISIONI I NJOHJES SË DIPLOMAVE

Nr. Prot. \_\_\_\_\_, Nr. Regjistrimit \_\_\_\_\_

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_

**VËRTETIM NJOHJE DHE NJËSIMI**

Vërtetohet njohja e diplomës/certifikatës së Z/Znj. \_\_\_\_\_ (emër atësi, mbiemër), lëshuar nga \_\_\_\_\_ (institucioni që ka lëshuar diplomën/certifikatën), \_\_\_\_\_ (shteti), më datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_ (data e lëshimit të diplomës), me program \_\_\_\_\_ vjeçar (kohëzgjatja e programit të studimit, \_\_ ECTS (numri i krediteve të fituara në rast kur këto disponohen), me kohë të \_\_\_\_\_, (forma e studimit), në \_\_\_\_\_ (emërtimi i programit të studimit).

Kjo diplomë/certifikatë njësohet si \_\_\_\_\_ në Republikën e Shqipërisë.

Ky vërtetim është i vlefshëm, i shoqëruar me diplomën e njohur dhe njësuar.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**KRYETARI I KOMISIONIT**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
MINISTRI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

**VËRTETIM NJOHJE DHE NJËSIMI**

Z/Znj. \_\_\_\_\_ (emër atësi mbiemër) ka fituar gradën shkencore “Doktor” në \_\_\_\_\_ (fushën e studimit), në Institucionin e Arsimit të Lartë “\_\_\_\_\_” (institucioni që ka lëshuar diplomën/certifikatën), më \_\_\_\_\_ (data e fitimit), nëpërmjet paraqitjes së disertacionit me temë: “\_\_\_\_\_” (titulli i disertacionit).

Në mbështetje të vendimit Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_ , të Komisionit të Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore (KNjG) të ngritur me Urdhrin Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_ , “Për ngritjen e Komisionit të Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore (KNjG)”, grada shkencore e sipërpërmendur, e fituar në \_\_\_\_\_ (Shteti), nga \_\_\_\_\_ (emër atësi mbiemër) është e barasvlershme me gradën shkencore “Doktor” në Republikën e Shqipërisë.

Grada shkencore “Doktor” i/e Z/Znj. \_\_\_\_\_ (emër atësi mbiemër) është regjistruar, me numër rendor \_\_\_\_\_ në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit, dhe të mbajtur në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Ky vërtetim është i vlefshëm, i shoqëruar me diplomën e doktoratës.

MINISTËR

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**  
**MINISTRI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_

**VËRTETIM I NJOHJES SË TITULLIT AKADEMIK**

Z. \_\_\_\_\_ (emër atësi mbiemër) ka fituar titullin akademik “ \_\_\_\_\_ ” (emërtimin e titullit të fituar), në \_\_\_\_\_ (fushën e studimit), në Institucionin e Arsimit të Lartë “ \_\_\_\_\_ ” (institucioni që ka lëshuar titullin akademik), më \_\_\_\_\_ (data e fitimit të titullit akademik).

Në mbështetje të vendimit Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_, të Komisionit *Ad Hoc* të ngritur me Urdhrin Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_, “*Për ngritjen e Komisionit Ad Hoc për njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vendit*”, titulli akademik i sipërpërmendur, i fituar në \_\_\_\_\_ (Shteti), nga \_\_\_\_\_ (emër atësi mbiemër) është e barasvlershme me titullin akademik “ \_\_\_\_\_ ” në Republikën e Shqipërisë.

Titulli akademik “ \_\_\_\_\_ ” i/e Z/Znj. \_\_\_\_\_ (emër atësi mbiemër) është regjistruar, me numër rendor \_\_\_\_\_ në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit, dhe të mbajtur në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Ky vërtetim është i vlefshëm, i shoqëruar me dëshminë e titullit akademik.

**MINISTËR**